

Data 31.08.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Lodra për të realizuar parqe rekreativ për fëmijë”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):) Lodra
37520000

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 660 900 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë mijë e
nëntëqind) lekë pa t.v.sh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”,autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Gjirokastr** ka hartuar procesverbalin për
argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën
e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM
nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", si dhe nenit

.....
(Shënim: *përcaktoni nëse është rasti, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).*

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024, 2025) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo me te vogël se 40% e vlerës së fondit limit**. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në vlerën e fondit limit, vlera është nën kufirin e ulët monetar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, pika "b", të ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjin nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" dhe neni 41, pika "b", e ligjit nr.10091 datë 5.3.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" i ndryshuar.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit** të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20. % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës merr përsipër të kryejë, me shpenzimet e veta, transportin, shkarkimin e mallrave në ambientet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor, brenda afateve të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për të garantuar dorëzimin e mallrave në ambientet e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe realizimin e plotë të furnizimit, pa krijuar kosto shtesë për Autoritetin Kontraktor.

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklarojë se malli i ofruar është në përputhje të plotë me specifikimet teknike të përcaktuara në Dokumentet e Tenderit dhe se do të funizohet i ri, i papërdorur më pare.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin

e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Synon garantimin e përputhshmërisë së mallrave me specifikimet teknike të kerkuara.

2.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të deklaroj se malli duhet të jetë i shoqëruar me garanci minimale 12 (dymbëdhjetë) muaj, e cila mbulon çdo defekt të prodhimit ose mosfunksionim që nuk vjen si pasojë e përdorimit të papërshtatshëm. Garancia do të përfshijë gjithashtu zëvendësimin ose riparimin pa kosto të çdo pjese që rezulton me defekt gjatë periudhës së garancisë, si dhe ofrimin e shërbimit të garancisë brenda afateve të përcaktuara nga kontrata.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kërkesa e mësipërme është e nevojshme për të garantuar cilësinë, funksionalitetin dhe përdorimin e qëndrueshëm të pajisjeve, si dhe për të siguruar mbështetje dhe zgjidhje të problematikave që mund të shfaqen gjatë periudhës së garancisë.

Specifikime teknike

1. Lojë rrëshqitëse me dy lisharse

- Pajisja të jetë e destinuar për përdorim në ambiente të jashtme (park lojërash për fëmijë).
- Të përbëhet nga **1 rrëshqitëse dhe 2 lisharse**.
- Struktura mbajtëse të jetë prej **çeliku të galvanizuar**, rezistent ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike.
- Elementët plastikë (rrëshqitësja, mbrojtëset ose pjesët përkatëse) të jenë prej **HDPE (High Density Polyethylene)**, rezistent ndaj rrezeve UV, lagështirës dhe ndryshimeve të temperaturës.
- Lisharset të jenë të pajisura me zinxhirë ose elementë mbajtës prej materiali rezistent ndaj korrozionit dhe me ulëse të përshtatshme për përdorim publik.
- Të gjitha lidhjet mekanike (vida, dado, rondele) të jenë prej **çeliku të galvanizuar ose inoksi**, rezistente ndaj korrozionit.
- Të mos ketë cepa të mprehtë ose pjesë që paraqesin rrezik për përdoruesit.
- Montimi të realizohet mbi bazament betoni, duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm të fiksimit.
- Pajisja të jetë e projektuar për përdorim të vazhdueshëm në ambiente publike dhe të ketë qëndrueshmëri të lartë mekanike.
- Të jetë në përputhje me standardin **EN 1176** ose **ekuivalent të vlefshëm**, për pajisjet e këndeve të lojërave për fëmijë.
- Garancia minimale të jetë **12 muaj** nga data e marrjes në dorëzim.
- Ngjyra të jetë rezistente ndaj zbehjes nga rrezet UV.
- Materialet të jenë jo toksike dhe të sigurta për fëmijët.
- Të jetë produkt i ri, i papërdorur dhe i shoqëruar me manual montimi dhe përdorimi.



Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përcaktuar për të garantuar furnizimin me një pajisje të sigurt, funksionale dhe të përshtatshme për përdorim në ambiente publike. Materialet e kërkuara sigurojnë rezistencë ndaj kushteve atmosferike, ndërsa kërkesa për **standardin EN 1176 ose ekuivalent të vlefshëm** garanton përmbushjen e kërkesave të sigurisë për pajisjet e këndeve të lojërave.

2. Lirsharëse në formë A

- Struktura mbajtëse të jetë në formë **A**, e prodhuar prej **çeliku të galvanizuar** ose ekuivalent, me rezistencë të lartë ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike.
- Të jetë e pajisur me **2 ulëse**, të përshtatshme për përdorim nga fëmijët, të prodhuara nga material rezistent ndaj goditjeve, lagështirës dhe rrezeve UV.
- Zinxhirët mbajtës të jenë prej **çeliku të galvanizuar** ose inox, me rezistencë të lartë ndaj konsumit dhe korrozionit.
- Të gjitha elementet e lidhjes (vida, dado, rondele) të jenë prej materiali rezistent ndaj korrozionit.
- Pajisja të mos ketë cepa të mprehtë ose elementë që mund të paraqesin rrezik gjatë përdorimit.
- Të parashikohet montimi mbi bazament betoni, duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm të fiksimit.
- Pajisja të jetë në përputhje me **Standardin EN 1176 ose ekuivalent të vlefshëm**.
- Garancia minimale të jetë **12 muaj** nga data e marrjes në dorëzim.



Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përcaktuar për të siguruar një pajisje me qëndrueshmëri të lartë, rezistente ndaj korrozionit dhe të përshtatshme për përdorim të vazhdueshëm në ambiente të jashtme. **Standardi EN 1176 ose ekuivalent i vlefshëm** kërkohet për garantimin e sigurisë së përdoruesve.

3. Lëkundëse sustë

- Pajisja të jetë e destinuar për përdorim në ambiente të jashtme (kënde lojërash për fëmijë).
- Trupi i lëkundëses të jetë i prodhuar nga **panel HDPE (High Density Polyethylene)**, rezistent ndaj goditjeve, lagështirës, konsumimit dhe rrezeve UV.
- Susta mbajtëse të jetë prej **çeliku me trajtim antikorroziv** (e galvanizuar ose e lyer me bojë pluhur elektrostatische), me rezistencë të lartë ndaj konsumimit dhe kushteve atmosferike.
- Pajisja të jetë e pajisur me doreza dhe mbështetëse për këmbët, të projektuara për përdorim të sigurt nga fëmijët.
- Të gjitha elementet e fiksimit (vida, dado, rondele) të jenë prej materiali rezistent ndaj korrozionit dhe të mbrojtura me kapakë sigurie.
- Të mos ketë cepa të mprehtë ose elementë që mund të paraqesin rrezik gjatë përdorimit.
- Montimi të realizohet mbi bazament betoni, duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm të fiksimit.
- Pajisja të jetë në përputhje me **Standardin EN 1176 ose ekuivalent të vlefshëm**.
- Garancia minimale të jetë **12 muaj** nga data e marrjes në dorëzim.



Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike synojnë furnizimin me një pajisje të sigurt dhe rezistente ndaj konsumimit dhe kushteve atmosferike. Materialet e përdorura dhe standardi **EN 1176 ose ekuivalent i vlefshëm** garantojnë cilësinë, jetëgjatësinë dhe sigurinë gjatë përdorimit.

4. Peshore për dy fëmijë

- Pajisja të jetë e destinuar për përdorim në ambiente të jashtme (kënde lojërash për fëmijë).
- Të përbëhet nga **një peshore me dy ulëse**, e projektuar për përdorim nga dy fëmijë njëkohësisht.
- Struktura mbajtëse të jetë prej **çeliku të galvanizuar** ose ekuivalent, me rezistencë të lartë ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike.
- Ulëset dhe dorezat të jenë të prodhuara nga **HDPE (High Density Polyethylene)** ose material ekuivalent, rezistent ndaj goditjeve, lagështirës dhe rrezeve UV.
- Pajisja të jetë e pajisur me **amortizues** prej gome ose materiali ekuivalent, të cilët reduktojnë goditjen gjatë përdorimit dhe rrisin sigurinë.
- Të gjitha elementet e fiksimit (vida, dado, rondevë) të jenë prej materiali rezistent ndaj korrozionit dhe të mbrojtura me kapakë sigurie.
- Pajisja të mos ketë cepa të mprehtë ose elementë që mund të paraqesin rrezik gjatë përdorimit.
- Montimi të realizohet mbi bazament betoni, duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm të fiksimit.
- Pajisja të jetë në përputhje me **Standardin EN 1176 ose ekuivalent të vlefshëm**.
- Garancia minimale të jetë **12 muaj** nga data e marrjes në dorëzim.



Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përcaktuar për të siguruar një pajisje të qëndrueshme, me elementë sigurie dhe rezistente ndaj përdorimit në ambiente publike. Kërkesa për **standardin EN 1176 ose ekuivalent të vlefshëm** garanton përputhshmërinë me kërkesat e sigurisë për pajisjet e këndeve të lojërave.

5. Lojë rrëshkitëse

- Pajisja të jetë e destinuar për përdorim në ambiente të jashtme (kënde lojërash për fëmijë).
- Të përbëhet nga **platformë, shkallë ngjitëse dhe rrëshqitëse**.
- Platforma dhe shkallët të jenë me **sipërfaqe antirrëshqitëse**, për të garantuar sigurinë gjatë përdorimit.
- Struktura mbajtëse të jetë prej **çeliku të galvanizuar** ose ekuivalent, rezistent ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike.
- Rrëshqitësja dhe panelet anësore të jenë prej **HDPE (High Density Polyethylene)** ose material ekuivalent, rezistent ndaj goditjeve, lagështirës dhe rrezeve UV.
- Të gjitha elementet e fiksimit (vida, dado, rondele) të jenë prej materiali rezistent ndaj korrozionit dhe të mbuluara me kapakë sigurie.
- Pajisja të mos ketë cepa të mprehtë ose elementë që mund të paraqesin rrezik gjatë përdorimit.
- Montimi të realizohet mbi bazament betoni, duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm të fiksimit.
- Pajisja të jetë në përputhje me **Standardin EN 1176** ose **ekuivalent të vlefshëm**.
- Garancia minimale të jetë **12 muaj** nga data e marrjes në dorëzim.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë hartuar për të garantuar furnizimin me një pajisje funksionale, të sigurt dhe rezistente ndaj kushteve atmosferike. Materialet e kërkuara dhe përputhshmëria me **standardin EN 1176 ose ekuivalent të vlefshëm** sigurojnë cilësinë dhe sigurinë gjatë përdorimit.

6. Rrotulluse me timon

- Pajisja të jetë e destinuar për përdorim në ambiente të jashtme (kënde lojërash për fëmijë).
- Të jetë e pajisur me **platformë rrotulluese me sipërfaqe antirrëshqitëse**, e projektuar për përdorim të sigurt nga fëmijët.
- Të jetë e pajisur me **timon qendror** ose sistem mbajtës për të mundësuar rrotullimin dhe për të rritur sigurinë gjatë përdorimit.
- Struktura mbajtëse të jetë prej **çeliku të galvanizuar** ose ekuivalent, rezistent ndaj korrozionit dhe kushteve atmosferike.
- Pajisja të jetë e pajisur me **kushineta të mbyllura, pa nevojë për mirëmbajtje (maintenance free)**, me rezistencë të lartë ndaj konsumimit.
- Platforma të jetë prej materiali rezistent ndaj konsumimit dhe kushteve atmosferike, me sipërfaqe antirrëshqitëse.
- Të gjitha elementet e fiksimit të jenë prej materiali rezistent ndaj korrozionit dhe të mbrojtura me kapakë sigurie.
- Pajisja të mos ketë cepa të mprehtë ose elementë që mund të paraqesin rrezik gjatë përdorimit.
- Montimi të realizohet mbi bazament betoni, duke përfshirë të gjithë elementët e nevojshëm të fiksimit.
- Pajisja të jetë në përputhje me **Standardin EN 1176 ose ekuivalent të vlefshëm**.
- Garancia minimale të jetë **12 muaj** nga data e marrjes në dorëzim.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përcaktuar për të siguruar një pajisje me funksionim të sigurt, jetëgjatësi të lartë dhe nevojë minimale për mirëmbajtje. Materialet e përdorura dhe kërkesa për **standardin EN 1176 ose ekuivalent të vlefshëm** garantojnë sigurinë dhe cilësinë e pajisjes.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

NJËSI E PROKURIMIT

Rigelsa Alikaj

Lorjana Shehu

Esmeralda Bezhani